




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ

RAPORT I PUNËS

JANAR – MARS 2024

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
Enver Shabani, drejtor

Mars, 2024

HYRJE

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar realizimin e aktiviteteve sipas Planit të Punës së Drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm sa i përket tërheqjes së investimeve dhe të realizimit të aktiviteteve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal dhe ngritjen e standardit të jetesës së qytetarëve të komunës së Gjilanit.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit janar – mars 2024 fokus të veçantë ju ka dhënë bashkëpunimit me donatorë, shoqërinë civile dhe të gjitha institucionet tjera te nivelit lokal e qendrore që prioritet e kanë Zhvillimin Ekonomik Lokal

Ambiciet e tona janë që të ndërtojmë parakushte të mira për ardhje të investimeve në komunën e Gjilanit dhe për zhvillim sa më të shpejtë ekonomik të saj.

Gjate kësaj periudhe kemi përmbyllë me suksesë projektin :**Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-UP dhe bizneset e grave ndërmarrëse 2023** dhe jemi në përgatitje për fazën e re për vitin 2024.

Ndërmarrësit e rinj dhe inovatorët me ide komerciale kanë mundësinë për t'u bërë pjesë e grantit po ashtu edhe bizneset Start-UP që do të fitojnë të drejtën për tu bërë pjesë e këtij programi.

Po ashtu Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë vitit 2024 ka planifikuar të punojnë Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 -2031.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit do të jetë dokument strategjikë **AMBICIOZ** që do të përfshirë të gjitha nevojat dhe ecjet në vitet e ardhshme.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka realizuar aktivitete të ndryshme dhe vizita përfshirë organizimin dhe pjesëmarrjen në punëtori ndryshme të organizuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare siç janë : Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Asociacioni i Komunave, USAID , Swisscontact, Qendrën për Arsimin në Kosovë (KEC), Përfaqësues të KFOR-it Turk për Rajonin Lindje, Organizata Jo Qeveritare “Germin”, Asociacion Kosovar për Energji të Ripërtritshme dhe Eficientë të Energjisë (AKEREE), Institutin Riinvest (Programi Green Action Space (GAS), Qendra për Aftësimin Profesional Gjilan, OJQ të ndryshme si dhe vizita të ndërmarrjeve publike komunale dhe vizita bizneseve lokale.

Gjate kësaj periudhe 3 mujore janë realizuar rreth 50 vizita në terren bizneseve, ndërmarrjeve publike, projekteve në realizim e sipër me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të ndryshme të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të Drejtorisë | Gjithashtu, janë mbajtur rreth 60 takime me palë të interesuara me ç'rast janë dhënë këshilla dhe udhëzime sipas kërkesave dhe nevojave të tyre në fushën e zhvillimit ekonomik.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me OJQ “Gruaja Hyjnore” ka organizuar dy panairë në Komunën e Gjilanit:

Panairi “Festo Tradicionalisht “ për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës



Tradita që zbukuron qytetin e Gjilanit | në 16 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës


Me dhjetëra stenda janë ngritur në sheshin “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha” ku janë ekspozuar punime të ndryshme tradicionale | si pjesë të traditës punime dhe prodhime nga dora e njeriut për këtë ditë të shënuar ku po dominojnë ngjyrat e kaltër, e verdhë e bardhe.

Kjo traditë e hershme në qytetin e bukur të Gjilanit nxjerr në pah punën dhe seriozitetin e artizanëve gjilanas të cilët ekspozojnë produktet e tyre duke tërhequr interesin e qytetarëve por edhe të turistëve, të cilët e vizitojnë Gjilanin në këto ditë feste .

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Gjilan, nëpërmjet këtij panairi, synohet stimulimin e një traditë e hershme e qytetit të Gjilanit, duke i ofruar çdo qytetari por edhe turisti produktin e traditës / Gjilani qyteti i tekstilit!

Panairi "Nënat Tona"

➤ *për nder të festave 7 Marsi - Dita e Mësuesit dhe 8 Marsi - Dita e Gruas.*



Panairi ka pas qëllim prezantimin e punimeve artizanale si veshje kombëtare, produkte ushqimore tradicionale të punuara dhe të gatuar nga gratë ndërmarrëse të qytetit të Gjilanit.

Ky panairi do të jetë dy ditor, i cili do të jetë i hapur me datat 7-8 Mars në sheshin "Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha".

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik ka ftuar të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit të jenë e pjesë e këtij panairi ku do të shohin për së afërmi produktet vendore të punuara nga gratë ndërmarrëse të Komunës së Gjilanit.

Panairët si një veprim ekonomik ju ka shërbyer komunitetit dhe bizneseve si një takim, pasi është rasti me i mirë për të reklamuar mallrat dhe për t'u njohur me produktet e reja, rasti i mirë për të rritur prodhimin dhe për tu njohur me kërkesat e konsumatorit, rasti i mirë për shkëmbimin e informacioneve dhe ideve mbi produktet, rasti i mirë për të ofruar më shumë zgjedhje për konsumatorët.


Gjate vitit 2024 Drejtorja për Zhvillim Ekonomik do organizojë edhe panairi "E Jona" për të cilën tani jemi në fazën e përgatitjeve.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve | gjatë periudhës 3 mujore Janar-Mars 2024 janë regjistruar 148 biznese të reja dhe të punësuar rreth 318 punëtorë ndërsa janë shuar 34 biznese.

Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Gjithësejt
Prodhuese	6	7	6	19
Tregtare	13	21	15	49
Shërbyese	23	16	32	71
Ndërtimore	1	4	4	9
Gjithësejt:	43	48	57	148
Pronare femra	7	10	10	27
Pronar meshkuj	36	38	47	121
Numri i punëtorve	71	76	171	318
Të dhëna tjera				
Prodhuese	1	2	1	4
Tregtare	3	5	3	11
Shërbyese	2	9	6	17
Ndërtimore	0	1	1	2
Gjithësejt:	6	17	11	34
Pronar meshkuj	5	12	8	25
Pronare femra	1	5	3	9
Numri i punëtorve	6	29	24	59

Skema 2



Programi i grandeve : Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-up dhe bizneset e grave ndërmarrëse 2023 dhe tani 2024 shpresojmë ti ndryshoj këto te dhëna e gjitha ne rritjen e numrit te bizneseve femra.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024 - 2031 : në përputhje me Vendimin e kryetarit të Komunës z.Alban Hyseni, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka organizuar dhe mbajtur takimin e parë për Hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 -2031.

Hartimi i Strategjisë është iniciativë e DZHE e cila do të realizohet në kuadër të përpjekjeve jo vetëm për të përmbush kërkesat ligjore por edhe për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal.

Kjo strategji ka për synim përdorimin në mënyrën më efektive dhe efikase të mundshme të burimeve njerëzore, natyrore, sociale, institucionale, financiare si parakusht për të krijuar një mjedis miqësor për qytetarët tanë, si dhe një mjedis të favorshëm për krijimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin e atyre ekzistuese, krijimin e vendeve të reja të punës dhe tërheqjen e investimeve duke ndikuar në përmirësimin e jetesës së qytetarëve.



Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Gjiçanit do të jetë dokument strategjikë **AMBICIOZ** që do të përfshirë të gjitha nevojat dhe ecjet në vitet e ardhshme, duke planifikuar saktë objektiva të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik për të gjitha bashkësitë të cilat jetojnë dhe veprojnë në Komunën tonë.

Spektori i Efiçiençës së Energjisë : Një tjetër sektor i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe Efiçienca e Energjisë. Gjatë kësaj periudhë të raportimit kanë filluar pagesat sipas planit të pagesave të tre projekteve për intervenim me masa të EE në tri shkollat e Komunës së Gjilanit :

- SH.M.T “Mehmet Isai” | vlera e projektit **224,290.86 €**

- SH.F.M.U “Rexhep Elmazi” | vlera e projektit **155,814.24 €**

- SH.F.M.U “Abaz Ajeti” | vlera e projektit **349,993.77 €**

Vlera e këtyre tri projekteve me masa të efiçiençës së energjisë me marrëveshje në mes Komunës së Gjilanit dhe Fondit të Kosovës për Efiçiençë të Energjisë kap vlerën rreth **730,098.87€**, po ashtu vlen të ceket se të gjitha punimet janë të përfunduara me sukses si dhe është bërë inaugurimi i tyre.

Drejtorja ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Ekonomisë dhe KFW (Banka Gjermane), për fillimin e zbatimit të masave të EE në objektet publike respektivisht për dy Shkollat Filllore: Shkollën Filllore të Mesme dhe Ulët “**Liria**” në fshatin dhe Pogragjë, dhe Shkollën Filllore të Mesme dhe Ulët “**Ibrahim Uruqi**” në fshatin Bresalc.

Gjatë kësaj periudhe tre mujore ka filluar vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomik të cilët kanë aplikuar për intervenim me masa efiçiente në dy shkollat e lartcekura.

Sipas Ministrisë marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Operatorit Ekonomik dhe Komunës së Gjilanit pritet të nënshkruhet gjatë muajit maj të vitit 2024.

Projekti Emergjent për Masat e Efiçiençës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore (sociale) në Pronësi të Komunës së Gjilanit.

Për dy objektet e banimit social të cilat janë përzgjedhur për financim nga Fondi i Kosovës për Efiçiençë të Energjisë janë në fazën e tenderimit dhe gjatë muajve në vazhdim pritet të nënshkruhet kontrata me operatorin ekonomik dhe të fillojnë punimet sipas planit dinamik.

Projektet e lartpërmendura në fushën e Efiçiençës së Energjisë synojnë intervenimin me masa të efiçiençës së energjisë në objektet publike duke mundësuar kursimin e konsiderueshëm të energjisë dhe realizimi i të cilave do të ndikojë në krijimin e vendeve të punës në sektorin e ndërtimitarisë.

Fondi për Ndërmarrësit e Rinjë : Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë kësaj periudhe tre mujore ka realizuar vizita në terren tek secili biznes përfitues me qëllim të verifikimit të gjendjes në teren dhe për t'u siguruar se janë duke u zbatuar projektet (pjesë përbërëse) sipas kontratës.

Përshkrimi	Femra	Meshkuj	Gjithsejtë
Sipas listës	38	7	45

Pjesë e regjistrorit / lista e përfituesve!


Skema 2 / sektorët përfitues nga programi

<i>Përshkrimi i pajisjeve</i>	<i>Numri i përfituesve</i>
<i>Rrobaqepësi</i>	<i>16</i>
<i>Fotografë</i>	<i>5</i>
<i>Prodhim Elektrike dhe drurit</i>	<i>1</i>
<i>Arkitekture</i>	<i>2</i>
<i>Sallon Ondulimi</i>	<i>6</i>
<i>Shërbime të kontabilitetit</i>	<i>1</i>
<i>Shëndeti njeriut</i>	<i>1</i>
<i>Prodhimi i Stolive (arit, argjendit) Zejtari</i>	<i>1</i>
<i>Marketing dhe web faqe</i>	<i>2</i>
<i>Prodhimi dhe lyerja e xhamave</i>	<i>1</i>
<i>Shërbime të avokatisë</i>	<i>1</i>
<i>Shërbime të pastrimit gjeneral</i>	<i>1</i>
<i>Shërbime të ndërtimit</i>	<i>1</i>
<i>Shërbime të instalimit (ujë, ngrohje, ajër)</i>	<i>2</i>
<i>Automekanik</i>	<i>1</i>
<i>Prodhimi dhe përpunimi i mishit</i>	<i>1</i>
<i>Prodhimi produkteve nga brumi</i>	<i>1</i>
<i>Shërbime lulishte, bimë</i>	<i>1</i>

Bazuar në të dhënat nga lista dhe vizita në teren!

Monitorimi në terren ka filluar bazuar në vendimin e komisionit me c'rast është përgatitur një formë e proces verbalit i cili ka shërbyer si model unik për realizim të këtij aktiviteti.

Gjatë vizitave monitoruese shumica e përfitueseve ju kanë përmbajtur kontratës si dhe kanë realizuar prokurimin sipas projektit dhe kontratës.



Megjithatë, janë dy raste të bizneseve përfituese të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet e kontratës edhe përkundër përpjekjeve të zyrtarëve të Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për të kuptuar arsyen e mos fillimit të zbatimit të projekteve.

Këto biznese janë kontaktuar përmes telefonit, e/malit si dhe janë realizuar vizita mirëpo kanë dështuar të realizohen sipas kontratës.

Gjatë realizimit të monitorimit të përfitueseve sipas projekteve të tyre kemi parë se janë krijuar 75 vende të reja të punës të cilat kanë ndikuar në zvogëlimin e papunësisë në Komunën tonë. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik edhe gjatë vitit 2024 do të hapë thirrjen e dytë të **“Fondit për Ndërmarrësit e rinj”** për subvencionim të bizneseve ekzistuese përfshirë ato të grave ndërmarrëse dhe biznese të reja start-up e cila pritet të publikohet në 6 mujorin e parë të këtij viti.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka vazhduar realizimin e aktiviteteve sipas planit të punës së Drejtorisë dhe gjate kësaj periudhe kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm sa i përket tërheqjes së investimeve dhe të realizimit të aktiviteteve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal dhe ngritjen e standardit të jetesës së qytetarëve të komunës së Gjilanit.

Sa i përket investimeve kapitale, **janë gjithsej 21 projekte të reja infrastrukturë publike dhe sociale** të cilat do të realizohen në bashkë-financim me Komunën e Gjilanit dhe me mbështetjen financiare nga niveli qendror (MMPH, ME, MKRS, MFPT, MZHR, FKKE, Islamic Relief) dhe donatorë (QATAR CHARITY, Islamic Relief Kosova, Advancing Together etj) të cilat kapin **vlerën prej 12,457,837.84 (€)**.

Marrëveshjet për bashkëfinancim të gjitha këtyre projekteve janë nënshkruar ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe donatoreve gjatë tre mujorshit të parë të këtij viti.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të bashkë-financoj projektet prioritare **në vlerën prej 5.785,276.75 (€)** nga të cilat **6,672,561.09 (€)** do të financohen nga donatorët.

Disa prej projekteve të investimeve kapitale sipas Marrëveshjeve me donatorë janë planifikuar të realizohen për periudhën dy-vjeçare dhe priten të përfundojnë në vitin 2024-2025 si në vijim projektet:

- 1.Kult Qendra / në lagjen Dardania
- 2.Zgjerimi dhe Asfaltimi i rrugës "Hamdi Kurteshi"
- 3.Palestra e sporteve "Bashkim Selishta"
- 4.Impianti për trajtimin e ujrave të zeza-Gjilan

Ndërsa punimet që janë duke vazhduar për realizimin e tri projekteve të bartura nga viti paraprak 2023-2024 siç janë :

Asfaltimi i rrugës në fshatin Haxhaj,

Terrenet sportive

Kanalizimi fekal Livoq i Poshtëm - Livoq i Epërm - Lagjja Kodra e Thatë

Skema e projekteve dhe të dhënave tjera | Investimet Kapitale

Nr .	Projekte të investimeve kapitale përmes kodit të bashkëfinancimit gjatë vitit 2024	Donatori	Vlera e Projektit	Financimi nga Donatori	BF nga DZHE/Komuna	Koment
1	Kult Qendra	MZHR	1,186,511.11	130,000.00	1,056,511.11	Është në proces të zhvillimit të punimeve
2	Asfaltimi i rrugës "Hamdi Kurteshi"	MMPHI	2,365,834.81		2,365,834.81	Është në proces të zhvillimit të punimeve
3	Mini parqet - Terenet Sportive në Fshatin Mihyr	MKRS	128,173.60		128,173.60	Është në proces të zhvillimit të punimeve
4	Palestra e sporteve "Bashkim Selishta"	MKRS	2,400,000.00	2,000,000.00	400,000.00	Është në proces të zhvillimit të punimeve
5	Projekti Smart City (Neutral Host)	ME	450,000.00	250,000.00	200,000.00	Është në proces të zhvillimit të punimeve
6	SH.F.M.U."Abaz Ajeti" Gjilan	FKEE	24,999.56		24,999.56	Është në proces të pagesave
7	SH.F.M.U."Rexhep Elmazi" Gjilan	FKEE	11,140.72		11,140.72	Është në proces të pagesave
8	SH.M.T."Mehmet Isai" Gjilan	FKEE	16,036.82		16,036.82	Është në proces të pagesave
9	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza-Gjilan	MFPT	3,125,014.00	3,125,014.00		Është në proces të zhvillimit nga MFPT
10	Asfaltimi Rrugës në fsh.Kokaj (Rruga Llovçë - Ranatovcë)	MPHI	569,135.37		569,135.37	Është në proces të zhvillimit të punimeve
11	Asfaltimi Rrugëve në fsh. Malishevë e ulët Faza-2	MPHI	191,645.78	92,193.00	99,452.78	Është në proces të zhvillimit të punimeve
12	Asfaltimi rrugëve Jonuz Tërstena-28 Nëntori dhe Krahët 1-5	MPHI	266,709.57	166,710.00	99,999.57	Është në proces të zhvillimit të punimeve

13	Asfaltimi Rrugëve "Qefsere Salihu" dhe "Blerim Halili"	MPHI	299,932.70	169,933.00	129,999.70	Është në proces të zhvillimit të punimeve
14	Asfaltimi Rrugëve ne lagjen Livadhet e Arapi	MPHI	250,100.00	150,101.00	99,999.00	Është në proces të zhvillimit të punimeve
15	Asfaltimi Rrugëve ne F.sh. Burincë	MPHI	303,021.00	203,021.00	100,000.00	Është në proces të zhvillimit të punimeve
16	Rregullimi i Trotuaret dhe Ndrëçimit (Haxhaj – Demiraj)	MPHI	155,762.72	105,763.00	49,999.72	Është në proces të zhvillimit të punimeve
17	Projekti Kryesor për Rrugën - Nëna Terezë - Gjilan	MPHI	512,625.00	200,000.00	312,625.00	Është në proces të zhvillimit të punimeve
18	Përkrahja e familjeve me ujë të pijshëm në fshatrat : Bresalc, Ponesh dhe Livoç)	Islamic Relief	201,195.08	79,826.09	121,368.99	Është në proces të zhvillimit të punimeve
Gjithsejtë :			12,457,837.84	6,672,561.09	5,785,276.75	

Drejtorja e vlerëson këtë periudhë si jashtëzakonisht të suksesshme sa i përket investimeve kapitale të cilat kontribuojnë direkt në zhvillim ekonomik lokal | Aktualisht janë gjithsej 21 projekte, ndërsa 3 janë projekte në realizim e sipër sipas marrëveshjeve nga viti 2023-2024 si dhe 4 projekte dy vjeqare në realizim sipër sipas marrëveshjeve 2024-2025.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Në tabelën e mëposhtme gjeni Raportin e Planifikimit fillestar të vitit 2024 dhe Shpenzimet e Drejtorisë të periudhës Janar-Mars 2024. Realizimi i shpenzimeve financiare me përqindje për periudhën tre mujore 2024 është 7.93% sipas planifikimit të shpenzimeve.

PLANIFIKIMI FILLESTAR - 2024									
Drejtoritë Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i punëtorëve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Rezervat sipas Ligjit buxhetit	Gjithsejtë €
Zhvillim Ekonomik	480/48027		98,999.99	95,000.00	2,000.00	178,000.00	1,238,017.00	-	1,612,016.99
Gjithsejtë €			98,999.99	95,000.00	2,000.00	178,000.00	1,238,017.00	-	1,612,016.99

SHPENZIMET - 2024									
Drejtoritë Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i punëtorëve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Rezervat sipas Ligjit buxhetit	Gjithsejtë €
Zhvillim Ekonomik	480/48027		27,623.16	30,000.00	200.00	-	70,000.00		127,823.16
Shpenzimet Shprehur në %			27.90	31.58	10.00	0.00	5.65		7.93
Vetëm te Zotuara			-	15,000.00	-	-	56,000.00		
Shpenzimi + Zotimi			27,623.16	45,000.00	-	-	126,000.00	-	127,823.16
Shpenzimet + Zotimet Shprehur ne %			27.90	47.37	0.00	0.00	10.18		7.93

Sipas Planit te Zotimit nga Granti për periudhën Janar-Mars | Sipas Planit te Shpenzimit nga Granti për periudhën Janar- Prill

AKTIVITETET E REALIZUARA

Inkubatori i Biznesit!

Numër	Shfrytëzuesi aktual		Hapësirat m ²	Dokumentacioni ligjor	Afati	Lokacioni
1	Kujdestaria Ministria e Bujqësisë	MB	4m ²	Memorandum Komuna - A. Pyjor Kosovës	Aktive	Kati përdhes
2	KK-Gjilan - Agjencia e Pyjeve	AP	43.16m ²	Memorandum Komuna - Agjencia e Pyjeve	Aktive	Kati përdhes
3	KK-Gjilan	KB	30.59m ²	KK-Gjilan	E lirë	Kati përdhes
4	KK-Gjilan	KB	30.59m ²	KK-Gjilan	E lirë	Kati përdhes
	Hapësirë Private	HP		Qendër tek.e IPKO		Kati përdhes
	Hapësirë Private	HP		Qendër tek. e IPKO		Kati përdhes
7	Shoqata e Inxhinierëve SHIAGJ	OJQ	30.59m ²	Marrëveshje KK-Shoqata e inxhinierëve	Proces kërkesë	Kati i Parë
	Hapësirë private	HP		Qendër solariumi		Kati i Parë
	Hapësirë private	HP		Qendër e kurseve		Kati i Parë
8	OJQ Gjilan- salla e praktikës	OJQ	8m ²	Memorandum Komuna - TIK-a	Proces kërkesë	Kati i Parë
8/A	OJQ Gjilan - Administrata e Shoqatës	OJQ	6m ²	Memorandum Komuna - TIK-a	Proces kërkesë	Kati i Parë
8/A1	OJQ Gjilan- salla e trajnimit	OJQ	16m ²	Memorandum KK - TIK-a	Proces kërkesë	Kati i Parë
10	OJQ Liza-R	OJQ	30.59m ²	Marrëveshje OJQ Liza-R dhe Z.Kryetarit	Proces kërkesë	Kati i Parë
11	Ministria e Bujqësisë/ Agjesioni Pyjor	MB	28m ²	Memorandum Komuna - A. Pyjor K.	Aktive	Kati i Parë
12	Arkiva e Prokurimit	KK	57.21m ²	Zyra e Prokurimi Gjilan	Mbyllur	Kati i dytë
	Hapësirë Private	HP		Qendër e kurseve gj. te huaja		Kati i dytë

	Hapësirë Private	HP		Banim familjar		Kati i dytë
13	"OJQ" Psikoterapeutët në veprim	OJQ	35.49m ²	Në proces të aprovimit sipas kërkesës te Zyra e Kryetarit	Proces kërkesë	Kati i dytë
14	Shoqata e grave Turko-Shqiptare "Fidan"	OJQ	48.33m ²	Në proces të aprovimit sipas kërkesës te Zyra e Kryetarit	Proces kërkesë	Kati i dytë
15	KK-Gjilan	IB	37m ²	Hapësirë e lirë	E lire	Kati i dytë
16	Shoqata e TMK-së "ELITA"	OJQ	27.76m ²	Marrëveshje OJQ ELITA dhe Z. Kryetarit	Proces kërkesë	Kati i dytë
17	AVUK - Zyra Regjionale	AVUK	46m ²	Memorandum KK-AVUK	Aktive	Kati i tretë
	Hapësirë korridori për nevoja të APK-së	MB		Shfrytëzim të APK-së, Arhivë		Kati i tretë
	Hapësirë private	HP		Hapësirë e hapur private		Kati i tretë
18	AVUK - Zyra Regjionale	MB	34m ²	Memorandum KK-AVUK	Aktive	Kati i tretë
19	OJQ "Fuqia Rinor"	OJQ	30.59m ²	Marrëveshje OJQ FBR dhe z. Kryetarit	Proces kërkesë	Kati i tretë
20	Ministria e Bujqësisë Agjensioni Pyjor	MB	28m ²	Memorandum Komuna - A. Pyjor	Aktive	Kati i tretë
21	Ministria e Bujqësisë Agjensioni Pyjor	MB	37m ²	Memorandum Komuna - A. Pyjor	Aktive	Kati i tretë



KOMUNA E GJILANIT
DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

DËGJIM PUBLIK

RREGULLORJA E ORARIT TË PUNËS PËR VEPRIMTARITË
EKONOMIKE NË KOMUNËN E GJILANIT!

 Salla e Kuvendit Komunal në Gjiçan

 22/03/2024 ora 10:30

 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Ju mirëpresim!

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik-Gjiçan | ka draftuar Rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Subjekteve Afariste në Territorin e Komunës së Gjiçanit!

“Në jetën tuaj afariste për çdo ditë merren vendime afariste, si dhe zgjidheni rrugët nëpër të cilat duhet të ec biznesi juaj – bëhu pjesë aktive e këtij debati”

Të gjitha komentet dhe propozimet tuaja lidhur me ndryshimin/plotësimin e Rregullores janë të mirëseardhura!

Takimi i parë :

Datë : 22.03.2024

Vendi : Salla e Kuvendit Komunal

Ora : 10:30

Duke qenë të hapur dhe transparente Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - Gjiçan po kontribuon në nxitjen e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe institucioneve, duke mundësuar kështu pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje, kjo rrjedhimisht po ndikonë në rritjen e besimit të publikut në institucione.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik-Gjiçan | Transparencën dhe llogaridhënia e institucioneve publike janë parakushtet kyçe për qeverisje të mirë dhe demokratike.

TË TJERA | AKTIVITETET E REALIZUARA



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik fillon një epokë e re e bashkëpunimit me Qendrën e Aftësimet Profesional (QAP) Gjiilan.

Gjatë takimit me drejtorin e Qendrës për Aftësimet Profesional Gjiilan, u bisedua rreth ndikimit të kësaj qendre në Zhvillimin Ekonomik Lokal

Komuniteti i biznesit do të ketë mundësin e aftësimet të punëtoreve të tyre në profile të ndryshme, kështu rritet efikasiteti në punë por edhe do të kujdeset edhe shërbimet për orientim në karrierë për të rrënjët e komunës së Gjiilanit.

Kohëzgjatja e trajnimit është 3-6 muaj, kandidati i nënshtrohet testit pas çdo moduli që zhvillohet si dhe testin përfundimtarë dhe pas trajnimit merr certifikatë mbi kompetencat e marra dhe me rëndësishmja është se trajnimet janë 30% teori dhe 70% praktikë.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik i ka hapur rrugë secilit aktivitet që ndikon në rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike, e gjitha me koordinim të plot me komunitetin e biznesit!

TË TJERA | AKTIVITETET E REALIZUARA



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka njoftuar ne vazhdimësi komunitetin e Biznesit me thirrjet per grante nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Këto tri grant skema janë: | Grant skema për blerjen e makinerive prodhuese dhe përpunuese. | Grant skema për certifikimin e produkteve. | Grant skema për digjitalizimin e bizneseve. | Qëllimi i kësaj mbështetjeje është të kontribuojë në rritjen e prodhimit dhe përpunimit, përmirësimin e bilancit tregtar, dhe të nxitë bizneset për të kontribuar në ekonominë qarkore dhe për të digjitalizuar bizneset e tyre.

Afati për aplikim është deri më 19 prill 2024, dhe aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova : <https://ekosova.rks-gov.net/>

Për më shumë informacion rreth procedurave të aplikimit dhe dokumentacionit të nevojshëm, mund të gjeni udhëzuesin për aplikuesit në Portalin e-Kosova dhe në web faqet e MINT dhe KIESA |

- Linku : makinerive prodhuese/përpunuese: ekosova.rks-gov.net/502
- Linku : certifikim të produkteve: ekosova.rks-gov.net/501
- Linku : transformim digjital: ekosova.rks-gov.net/504

MINT dhe KIESA janë të përkushtuar në përkrahjen e vazhdueshme të bizneseve në Kosovë, që të jenë konkurruese me produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe rrisin më tej eksportin në tregun ndërkombëtar!

Po ashtu Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ne bashkpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe AZHR Lindje ka realizuar takim konsultative me bizneset që operojnë në Rajonin Lindje.

Gjatë takimit Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka njoftuar bizneset dhe ndërmarrësit e ri që si rrjedhojë e përgatitjeve për shpalljen e Thirrje për propozime – Grante për Biznese 2024 | komunikimi dhe informimi për së afërmi me bizneset lidhur me vështirësitë dhe prioritetet e tyre zhvillimore është rendësi parësore e politikave zhvillimore ne nivel qendror dhe lokal.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik me qëllim të kordinimit të veprimeve me kompanitë publike për të rritur efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka bashkëpunuar ngusht me :

- NPL “Tregu”,
- NPL “Stacioni i Autobusëve” dhe
- PPP “Eco-higjiena”

Drejtoria do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë dhe është në kërkim të partneriteteve me të gjithë akterët relevant në nivel lokal dhe qendror, donatorë, shoqëri civile, komunitet të biznesit, me qëllim të koordinimit të iniciativave dhe aktiviteteve të cilat ndikojnë në rigjenerimin ekonomik, rritjen ekonomike si dhe përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetesës së qytetarëve.

Enver Shabani

Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik